


REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. lloji Broj stranica Nr. paget	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	01-3407/14
Data Datum Date	30.09.2014
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupcionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupcionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupcionit me datë 29.09.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllt rasti me nr. AKK-03-2170/14, për z. Besim Kuqi, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Therandës(Suharekës), për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I Në rastin e shqyrtuar për konflikt te interesit me numër protokolli AKK-03-2170/14,qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z.Besim Kuqi, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Therandës(Suharekës).

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Therandës(Suharekës),është duke ushtruar edhe funksion ne veprimtari private pra është identifikuar si person i autorizuar ne një biznes privat, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situate paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupcionit me datën 07.07.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z., Besim Kuqi, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Therandës(Suharekës), pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar qe ti bëhet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm te interesit.

Zyrtarët e Agjencisë ne takimin qe është mbajtur me z. Kuqi, me datën 22.07.2014 e kanë njoftuar me faktet qe posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit ne ushtrim te funksionit publik, ndërsa, z. Kuqi është pajtuar me gjendjen, mirë po ka dëshmuar se biznesi nuk zhvillon aktivitet, ndersa është zotuar se ne afat sa me te shpejt do te tërhiqet nga personi i autorizuar ne biznesin privat familjar, dhe do bëj ndryshimet e nevojshme dhe do te shmanget nga situata e mundshme e konfliktit te interesit.

Me datën 12.09.2014, z. Besim Kuqi, pas disa problemeve qe ka pas, ka sjell ne AKK-ë dokumentet zyrtare te lëshuar nga ARBK-ja ku dëshmohet se janë ber ndryshimet e këruara dhe se ne biznesin familjar privat me nr biznesi 70738430 dhe emër N.N.SH "Enkel" - zyrtari ne fjalë nuk figuron si person i autorizuar ne ketë kompani pasi qe është larguar nga personi i autorizuar ne biznesin familjar dhe nuk mban pozitën e pronarit si aksionar ne ketë biznes.

Vlerësojmë se zyrtari i lartë publik z. Besim Kuqi me largimin e tij nga funksioni i personit te autorizuar ne biznesin privat me emër N.N.SH "Enkel", ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

**II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.**

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

